



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK



Nr 25 Prot

Vau Dejës, me 07/01/2019

VENDIM

Nr. 89 Date 24/12 2019

**Për dhënie pëlqimi për kalimin e të drejtës së pronësisë për efekt legalizimi të parceses ndërtimore në posedim të z. Edison Asim Shimaj**

Nisur nga kërkesa e Agjencise Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Shkoder, me nr. Prot. 8418 date 17.10.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë nr. 7667 date 11.12.2017, si dhe referuar ligjit 9482 datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve informale" ndryshuar, neni 15/1 pika 2, VKM nr 465 date 22.06.2016 "Për Përcaktimin e Proçedurave dhe Rregullave për Kalimin e së Drejtës së Pronësisë mbi Parcelen Ndërtimore të Objekteve Informale" pika 19 ku citohet se:

*Kërkesa për miratim nga bashkia kompetente, sipas pikës 2, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, paraqitet nga drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t, përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe masës e vlerës së kompensimit financiar. Kjo kërkesë paraqitet për të gjitha parcelat ndërtimore në pasuritë e transferuara në pronësi të bashkisë, brenda territorit të njësisë administrative përbërëse.*

*Kërkesa merret në shqyrtim nga këshilli bashkiak, i cili duhet të vendosë për miratimin e tjetërsimit, duke nxjerrë pasuritë (ose pjesë të tyre) nga inventari i pronave të bashkisë.*

*Kur bashkia ka vetëm të drejta administrimi mbi pasurinë, ajo njoftohet për faktin e kalimit të pronësisë përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, me qëllim nxjerrjen e pasurisë (ose pjesës së saj) nga inventari i pronave të bashkisë.*

*Si dhe mbeshtetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqerisjen vendore", neni 54, 55, ndryshuar.*

**Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilesuar të votave,**

**VENDOSI**

- Ti jepet pëlqim Agjencise Shtetërore të Kadastres, Drejtoria Shkoder për kalimin e së drejtës së pronësisë të sipërfaqes prej **55.6 m<sup>2</sup>** të parceses ndërtimore të z. **Edison Asim Shimaj**, pjesë e pasurisë nr. **536/5**, ndodhur në ZK **1329**, Nj.A. Bushat, Bashkia Vau Dejës, pasuri e cila është kaluar në pronësi ish Komunes Bushat me VKM 68 dt. 28.01.2008(ndryshuar).